



## DEKLARATË PUBLIKE

16 Qershor, 2022 – Organizata GERMIN, përmes kësaj deklaratë, reagon ndaj lajmeve të shpërndara në media më datë 8 qershor 2022. Në këto lajme përmendet emri i organizatës sonë në kuadër të partneritetit mes Caritasit-it Zviceran dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR), përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) të Republikës së Kosovës, me pohimet se jemi pjesë e një marrëveshjeje të kundërligjshme dhe të ndikuar politikisht.

Përmes kësaj deklarate, ne e rinjoftojmë opinionin publik se jemi partner zbatues të projektit “Municipal Action for Reintegration and Diaspora – MARDI” apo “Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë”. Më saktësisht, ne do të zbatojmë komponentën e tretë të këtij projekti, e cila ka për qëllim mobilizimin e burimeve njerëzore dhe financiare të diasporës për zhvillimin ekonomik të Komunave të Kosovës. Partneriteti mes GERMIN dhe Caritasit-it Zviceran është arritur pas disa muajsh negociata dhe diskutime mes nesh, të cilat kanë nisur në qershor të vitit 2021. Ky proces i është përcjellë me respekt të ndërsjellë, duke respektuar pavarësinë e plotë të palëve deri në arritjen e një formati të përshtatshëm për zhvillimin e partneritetit. Bashkëpunimi ynë me Caritas-in Zviceran vjen krejtësisht natyrshëm dhe është i bazuar në përputhshmërinë e vizionit tonë me veprimtarinë mbi 20 vjeçare në të Caritas-it Zviceran dhe objektivat e tyre lidhur me asistencën financiare dhe zhvillimore në Kosovë. Ndërkohë, puna jonë e deritanishme, si njëra nga organizatat e vetme në Kosovë, e specializuar në angazhim të diasporës në fusha të ndryshme, përfshirë edhe atë të zhvillimit ekonomik është në relevancë të plotë me objektivat e projektit MARDI që synon mbështetjen e nivelit lokal të qeverisjes dhe tërheqjen e investimeve nga diaspora.

Lidhur me pohimet se përfshirja e GERMIN në projektin MARDI është e ndikuar politikisht për arsye financiare, njoftojmë se ne si organizatë nuk kemi aktualisht asnjë marrëdhënie kontraktuale direkte që përfshin mbështetje financiare me asnjë nga institucionet e Republikës së Kosovës. GERMIN nuk ka përfituar asnjë lloj mbështetje financiare nga MPJD ose MZHR në 4 vitet e fundit. Financimi i projektit MARDI buron nga 50% fonde zvicerane dhe me pak se aq nga mbështetja e institucioneve të Kosovës, përkatësisht MZHR. Përtej kësaj, GERMIN kontribuon me mbi 10% në kuadër të komponentës mobilizimin e burimeve njerëzore dhe financiare të diasporës për zhvillimin ekonomik të komunave të Kosovës.



Gjithashtu, partnerë në këtë projekt janë edhe 10 komuna të Republikës së Kosovës, të cilat udhëhiqen nga kryetarë legjitimë që vijnë nga grupime të ndryshme politike. Ndërkohë, në proces për arritjen e partneritetit janë edhe institucione të tjera relevante si Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrësise (KIESA) dhe odat dhe asociacionet ekonomike. Pra, bëhet fjalë për një koalicion hisedarësh që kanë qëllim të përbashkët – nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal përmes përfshirjes dhe angazhimit të diasporës.

Si organizatë, ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht të hapur për bashkëpunim me të gjithë ata që ndajnë vizione dhe objektiva të përbashkëta, pavarësisht bindjeve politike. Të gjitha partneritetet e GERMIN, përfshirë atë me Caritas-in Zvicëran, zbatojnë standardet më të larta të transparencës, prokurimit, monitorimit dhe vlerësimit. Aktivitetet dhe financat e organizatës sonë vlerësohen çdo vit nga auditorë të jashtëm dhe janë të pasqyruara në uebfaqen e organizatës.

GERMIN është organizatë, parimet dhe idealet e së cilës mbështeten në besimin se diaspora mund dhe duhet të luaj një rol proaktiv në zhvillimin dhe demokratizimin e vendeve amë. GERMIN ka nisur si grupim joformal në vitin 2011, është regjistruar si organizatë joqeveritare në Kosovë në vitin 2014 dhe si organizatë jo-fitimprurëse në Shqipëri në vitin 2020. GERMIN udhëhiqet nga një rrjet profesionistësh nga diaspora, të cilët shquhen për integritet të lartë dhe profesionalizëm në vendet më të zhvilluara të Europës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.